

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 57935/18

Artan BROCI

kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 20 maj 2025 si një Komitet i përbërë nga:

Úna Ní Raifeartaigh, *kryetar*,

Darian Pavli,

Mateja Đurović, *gjyqtarë*

dhe Olga Chernishova, *zëvendësekretare e Seksionit*,

Duke mbajtur në konsideratë:

kërkesën (nr. 57935/18) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”) më 10 dhjetor 2018 nga një shtetas shqiptar, z. Artan Broci (“kërkuesi”), lindur në vitin 1973 dhe me banim në Tiranë. Ai u përfaqësua në Gjykatë nga S. Z. A. Saccucci dhe znj. G. Borgna, avokatë që e ushtrojnë ligjin në Romë;

vendimin për të njoftuar mbi ankesat Qeverinë shqiptare (“Qeveria”), përfaqësuar nga Z. O. Moçka, avokat i përgjithshëm i shtetit. Këto kërkesa kishin të bënin me të drejtat e kërkuesit për t’u dëgjuar nga një gjykatë e paanshme dhe për respektimin e jetës private;

vërejtjet e palëve;

vendimin për të rrëzuar kërkesën e ankuesit për përjashtimin e Darian Pavlit, avokat i zgjedhur për Shqipërinë, në gusht 2021 (ish-Rregulli 28 § 2 (d) i Rregullores së Gjykatës);

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

LËNDA E ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë me shkarkimin e kërkuesit nga detyra nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit (KPA) (shih *Xboxhaj kundër Shqipërisë*, nr. 15227/19, 9 shkurt 2021).

2. Kërkuesi ka shërbyer si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Tiranë prej vitit 1996 deri në vitin 2010, dhe në vijim si gjyqtar i gjykatës së apelit dhe i Gjykatës së Lartë. Ai ka shërbyer edhe si anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD) nga viti 2013 deri në vitin 2017.

3. Gjatë një mbledhje të KLD-së në maj 2014, midis kërkuesit dhe S. Ç. – një anëtar tjetër i KLD-së – pati një konfrontim. S. Ç. kritikoi mënyrën se si KLD-ja trajtonte transferimet gjyqësore, proceset disiplinore, emërimet në gjykata, dhe menaxhimin e përgjithshëm, duke argumentuar se masat e KLD-së kishin shkaktuar mungesë efikasiteti dhe dështime në sistemin gjyqësor. Kërkuesi u përgjigj duke e mbrojtur punën e KLD-së, duke nënvizuar numrin e madh të mbledhjeve dhe përpjekjet për të vlerësuar gjyqtarët, dhe në të njëjtën kohë kritikoi S. Ç. për rolin e tij në KLD, duke pretenduar se kishte mospërputhje në deklaratimet dhe veprimet e tij. Debati solli ndërhyrjen e kryetarit të mbledhjes, i cili kërkoi që të ruhej rendi dhe të fokusoheshin në agjendë.

4. Më 31 korrik 2018, KPK-ja shkarkoi kërkuesin nga detyra, me shumicë votash. Pas apelimit të tij në KPA, çështja iu caktua një paneli me pesë gjyqtarë të përbërë nga I. R. (kryetare), A. H. (relator), L. D., S. Ç. dhe A. S. Kërkuesi kundërshtoi S. Ç., i cili më herët kishte qenë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Tiranë, zëvendëskryetar dhe kryetar i saj, dhe kishte qenë anëtar i KLD-së në vitet 2000, nga viti 2014 deri në vitin 2017. Ai deklaroi se më herët ata kishin pasur debate të ashpra dhe opinione të

ndryshme për mënyrën se si S. Ç. kishte votuar për kundërshtarin e kërkuarit në një konkurs për pozicionin e kryetarit të asaj gjykate në tetor 2006. Kërkuari bashkëngjiti procesverbalet e mbledhjeve të KLD-së në shkurt dhe maj 2014, nëntor 2015 dhe mars 2016, dhe të një seance dëgjimore të vitit 2006.

5. Një panel i përbërë nga A. H., A. S., N. M., L. D. dhe R. S. e rrëzuan me shumicë votash kërkesën për përjashtim si në vijim:

a) Kërkuari nuk paraqiti prova për të provuar anshmërinë subjektive të S. Ç. Sipas dokumentit të vitit 2006 dhe procesverbalit të katër mbledhjeve të KLD-së në periudhën 2014–16, nuk vërtetohet pretendimi për debate të forta, ku pretendohet se S. Ç. ka mbajtur qëndrime politike në KLD. Këto akte nuk provonin se natyra e marrëdhënies së tyre ishte e tillë që të provonte mungesën e paanshmërisë së S. Ç. në procesin e *vetting*-ut. Në lidhje me debatet e tyre në gjykatën e rrethit ose zgjedhjen e supozuar të S. Ç. për të mosmbështetur kandidaturën e kërkuarit në vitin 2006, ato nuk krijojnë një arsyetim legjitim për të pasur frikën se S. Ç. nuk ishte i paanshëm. Ngjarjet kishin ndodhur më shumë se 12 vite më parë, gjë që është një konsideratë e rëndësishme sipas standardeve ndërkombëtare për etikën gjyqësore dhe paanshmërinë.

b) Diskutimet ose vendimmarrja brenda një organi kolegjial si KLD-ja, ose çdo organi tjetër vendimmarrës në sistemin e drejtësisë, mbaheshin sipas ushtrimit të një funksioni publik, duke përfaqësuar Shtetin dhe interesin publik. Vendimet e marra gjatë përmbushjes së detyrave kushtetuese dhe ligjore nuk mund të krijojnë një marrëdhënie personale me personat për të cilët këto vendime pasjellin efekte juridike (jo) të drejtpërdrejta.

6. Më 18 korrik 2019, KPA-ja, në mënyrë unanime, la në fuqi shkarkimin e kërkuarit nga detyra për shkak se ai nuk përmbushi detyrimet për vlerësimin e pasurisë (neni 61(3) i ligjit për *vetting*-u, LV), veçanërisht:

a) Në vitin 2006, ai bëri një kontratë porosi për një shtëpi plazhi në Durrës nga Kompania L për 55,140 euro, kishte paguar kështu e parë prej 20,000 eurosh dhe më pas kishte përfituar një ulje prej 5,140 eurosh, kur kishte paguar pjesën tjetër në vitin 2007 (ai kishte lidhje shoqërore me një nga partnerët e kompanisë). Megjithatë, në deklaratimet për *vetting*-un, kërkuari kishte deklaruar si çmim përfundimtar 55,000 euro, duke mosparaqitur çmimin e vërtetë. Ai kishte cituar kursimet midis burimeve të financimit, megjithatë analiza financiare e KPA konstatoi se, edhe nëse të gjitha burimet e të ardhurave të deklaruara për vitin 2006 do të konsideroheshin të ligjshme dhe të provuara, ai përsëri do të kishte një gjendje negative financiare (që do të thotë shpenzime të pajustificuara) për atë vit.

b) Kërkuari deklaroi se ai kishte investuar 82,000 euro në bono thesari në maj 2010 dhe se ajo shumë kishte ardhur nga shuma prej 102,000 eurosh që ai kishte marrë në para në dorë në prill 2010 nga shitja e shtëpisë së plazhit në Durrës për F.G. Megjithatë, kërkuari nuk mundi të provonte se ai i kishte marrë në fakt 102.000 euro, dhe në këtë mënyrë burimi i atij investimi nuk mund të përcaktohet në mënyrë të besueshme. Veçanërisht, në prill 2010, kompania L kishte lidhur kontratë për të njëjtën banesë me F. G., që kishte paguar 82,000 euro për Kompaninë L në prill 2010 dhe 20,000 euro në dhjetor 2010. Kontrata përfundimtare e shitjes për banesën ishte nënshkruar në vitin 2016, përsëri midis F. G. dhe kompanisë. Ekzistenca e dy kontratave për të njëjtën pronë, vlera e së cilës (çmimi i rishitjes) ishte dyfishuar në katër vite (pavarësisht lidhjeve shoqërore të kërkuarit me F. G.) ngriti pikëpyetje. Kërkuari nuk paraqiti shpjegime bindëse për këto transaksione.

c) KPA-ja iu referua deklaratimeve jokonsistente të kërkuarit në lidhje me pagesën prej 45,000 dollarësh amerikanë për një zyrë në Tiranë në shkurt 2003, pjesërisht, me anë të një huaje bankare prej 24,000 dollarësh amerikanë të marrë në muajin qershor 2003. Ai e kishte deklaruar huan në deklaratën e *vetting*-ut në vitin 2017 si burim për të përfituar një zyrë. Si përgjigje ndaj pyetjeve të KPK-së gjatë hetimit në shkurt 2018, ai pretendoi fillimisht se e kishte përdorur huan bankare për të shlyer paratë që i kishte marrë një të afërmi. Megjithatë, një gjë e tillë as nuk ishte deklaruar dhe as nuk ishte provuar

në deklaratimet për *vetting*-un apo në deklaratimin e përvitshëm për vitin 2003. Fondet ishin tërhequr në para në dorë nga banka, pa prova për përdorimin e tyre specifik. Në këtë mënyrë, kërkuesi nuk arriti të provonte origjinën e ligjshme të 24,000 dollarëve amerikanë të paguar në shkurt 2003.

Së fundmi, KPA-ja arriti në përfundimin se kërkuesi nuk kishte mundur të parandalonte një situatë konflikti interesi: (i) në vitin 2014 duke mos u tërhequr nga dëgjimi i një çështjeje me padi prej 391,260 eurosh ndaj Kompanisë L prej së cilës ai kishte blerë pronën në Durrës dhe kishte përfutur uljen prej 5,140 eurosh në vitin 2007; dhe (ii) në dy çështje të tjera. Një gjë e tillë kishte cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë (neni 61 (5) i LV).

VLERËSIMI I GJYKATËS

A. Neni 6 i Konventës

1. Parashtrimet e palëve

7. Qeveria argumentoi se ankesa ishte qartazi e pambështetur në fakte. Veçanërisht, debatet midis kërkuesit dhe S. Ç. kishin ndodhur në kuadrin e opinioneve të ndryshme që ata të dy, së bashku me 13 anëtarë të KLD-së, kishin për çështje të paraqitura për shqyrtim nga ai organ kolektiv. Mosmarrëveshje të tjera të pretenduara kishin të bënin me administrimin e gjykatës së rrethit nga S. Ç. në një periudhë edhe më të hershme. S. Ç., një prej pesë gjyqtarëve në panel, as nuk kishte kryesuar dhe as nuk kishte relatuar. Vendimi i trupës gjyqësore kishte qenë unanim, kishte vlerësuar të gjitha pikat e apelimit dhe kishte ofruar arsyet e përshtatshme. S. Ç. nuk kishte shprehur asnjë pozicion, dhe as nuk kishte ndërmarrë procedura disiplinore ndaj kërkuesit. Në çështjen e *vetting*-ut, gjyqtari S. Ç. nuk kishte paraqitur vlerësime personale për procesin e vendimmarrjes në çështjen e kërkuesit, mënjanë vendimit gjyqësor. Konflikti i pretenduar personal midis S. Ç. dhe kërkuesit, brenda gjykatës së rrethit dhe KLD-së (edhe pse i paprovuar) kishte ndodhur në të shkuarën e largët.

8. Kërkuesi pretendoi se gjyqtari i KPA-së, S. Ç., nuk kishte treguar paanshmëri objektive dhe subjektive (shih paragrafët 3 dhe 4 më sipër). Marrëdhënia e tyre armiqësore ishte përkeqësuar në vitin 2014, pak vite përpara procesit të *vetting*-ut. S. Ç. kishte kritikuar haptazi menaxhimin e përgjegjësive të KLD-së nga kërkuesi dhe anëtarë të tjerë të këshillit. Në mbledhjen e KLD-së në maj 2014, ai e kishte akuzuar kërkuesin për “gënjeshtër, mashtrim dhe shpifje” kur kërkuesi kishte pretenduar se S. Ç. nuk përmbushte kriteret ligjore për të qenë në KLD. Edhe pse armiqësia e tyre e ndërsjellë kishte filluar gjatë ushtrimit të funksioneve publike, konfrontimet e tyre u përshkallëzuan në sulme personale. Procesverbalet e mbledhjeve të KLD-së konfirmonin se këto ndërveprime konstatonin një armiqësi substanciale midis të dyve. Ato nuk ishin mosmarrëveshje thjesht profesionale, veçanërisht teksa të dy u jepnin zë në mënyrë të vazhdueshme kritikave të forta për njeri-tjetrin. KPA-ja e kishte rrëzuar kërkesën për përjashtim me arsyetim arbitrar, duke mos shuar frikërat e S. Ç. për anshmëri. Vetëm dy ditë përpara se ta rrëzonin kërkesën, KPA-ja kishte rrëzuar S. Ç. në një tjetër çështje ku përfshihej një ish-anëtar i KLD-së.

2. Vlerësimi i Gjykatës

9. Parimet e përgjithshme përkatëse të lidhura me vlerësimin e paanshmërisë përmbledhen në vendimin *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë* [DHM], nr. 55391/13 dhe 2 të tjerë, §§ 145-47, 6 nëntor 2018, dhe *Rustavi 2 Broadcasting Company Ltd dhe të tjerë kundër Gjeorgjisë*, nr. 16812/17, §§ 331-32 dhe 359, 18 korrik 2019.

10. Kërkuesi nuk i ofroi panelit të përjashtimit nga trupa gjyqësore detaje apo prova për natyrën dhe intensitetin e konflikteve të pretenduar me S. Ç. gjatë funksionit të tyre përpara vitit 2006 në një gjykatë rrethi. Fakti se S. Ç. kishte votuar në vitin 2006, brenda një organi vendimmarrës kolegjal, për një kandidat tjetër për pozicionin e kryetarit të gjykatës në vetvete nuk krijonte dyshime legjitime për paanshmërinë e S. Ç. në vitin 2019. Pa elemente shtesë kontekstuale, vetëm ajo votë ishte e pamjaftueshme për të vënë në pikëpyetje paanshmërinë e tij më shumë sesa një dekadë më vonë. Sipas procesverbaleve të tre seancave të KLD-së, kërkuesi nuk paraqiti ndonjë përmbajtje specifike, dhe

Gjykata nuk konstaton ndonjë incident, që do të vërtetonte ose konstatonte kërkesën për tërheqje. Sipas mbledhjes në maj 2014, teksa diskutimi midis kërkuarit dhe S. Ç. me raste kishte pasur kritika që mund të karakterizohen si kritika që hyjnë në jetën personale, Gjykata vlerëson se një rast i tillë në kontekstin e diskutimit kolektiv, në vetvete, nuk mund të merret si provë e një armiqësie personale që do të ndikonte, ose që mendohej se ndikonte në paanshmërinë e një gjyqtari, që duhet të prezumohet deri sa të ketë prova për të kundërtën (shih *Rustavi 2 Broadcasting Company Ltd dhe të tjerë*, cituar më sipër, §§ 331 dhe 361, me referenca të tjera). Nuk rezulton se S. Ç. shprehu gatishmërinë për t'u hakmarrë ose për të kërkuar hakmarrje me anë të rrugëve juridike të disponueshme (*ibid.*, §§ 359 dhe 361), apo se pas kësaj ndërveprimi i tyre, nëse kishte ndonjë të tillë, të ishte problematik.

11. Pasi shqyrtoi provat e vëna në dispozicion dhe parashtrimet e palëve, Gjykata nuk konstaton arsye për të mos rënë dakord me vlerësimin e KPA-së në përgjigje të kundërshtimit të kërkuarit për animozitetin personal të S. Ç. gjatë procesit të apelimit në vitin 2019, në lidhje me kërkesën e paanshmërisë subjektive dhe objektive.

12. Kjo ankesë është qartazi e pambështetur në fakte dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

B. Neni 8 i Konventës

1. Parashtrimet e palëve

13. Qeveria kundërshtoi argumentet e kërkuarit si qartazi të pambështetur në fakte.

14. Kërkuari pretendoi se shkarkimi i tij nga detyra nuk ishte në përputhje me ligjin, nuk ndiqte ndonjë qëllim legjitim dhe ishte shpërpjesëtimor. Në vërejtjet e tij, ai kundërshtoi gjetjet faktike të KPA-së dhe mungesat financiare të pretenduara. Veçanërisht, KPA-ja u mbështet në një raport financiar që nuk ishte publik për të lënë në fuqi përfundimin e KPK-së se kërkuari kishte pasur fonde të pamjaftueshme të ligjshme ose të deklaruara për blerjen e bërë në vitin 2006. Kjo e vendoste atë në një disavantazh të padrejtë pa një shpjegim të qartë për mënyrën se si KPA-ja kishte përcaktuar gjendjen financiare negative. Kontrata në vitin 2010 paraqiste kushtet e pagesës, dhe KPA-ja e pranoi se atij nuk i ishte kërkuar ligjërisht që të përdorte metoda pagese të gjurmueshme. Megjithatë, sidoqoftë ai u shkarkua pasi nuk provoi të kishte marrë çmimin e rishitjes, sepse vet kontrata nuk provonte një pagesë faktike. Për sa i përket zyrës në Tiranë, KPK-ja nuk kishte transferuar barrën e provës tek ai në lidhje me 24,000 dollarë amerikanë dhe e kishin lënë në terr informacioni për përfundimet e saj përfundimtare për atë shumë; KPA-ja kishte kundërshtuar mandatpagesat dhe deklaratën e betimit të huadhënësit të vitit 2018 si prova jorelevante. Ai nuk kishte deklaruar huan e të afërmit të tij pasi kjo ishte paguar brenda disa muajve, dhe legjislacioni në vitin 2003 kërkonte vetëm bërjen publike të shlyerjeve të huas në proces.

2. Vlerësimi i Gjykatës

15. Shkarkimi i kërkuarit nga detyra ndërhynte me të drejtën e tij për respektimin e jetës së tij private dhe do të shkelte nenin 8 të Konventës, me përjashtim të rastit nëse do të justifikohesh se kjo gjë është në përputhje me ligjin dhe është e nevojshme në një shoqëri demokratike për të përmbushur një qëllim legjitim (shih *Thanza kundër Shqipërisë*, nr. 41047/19, § 135, 4 korrik 2023).

16. Për sa ka të bëjë me vlerësimin e pasurisë, duke përfshirë pronën në Durrës, argumentet e kërkuarit që kundërshtojnë ligjshmërinë e ndërhyrjes dhe mungesën e qëllimit legjitim janë të ngjashme me ato që tashmë janë rrëzuar nga Gjykata në një kontekst të ngjashëm (shih *Thanza*, cituar më sipër, §§ 141-47, me referenca të tjera). Mbetet për t'u vlerësuar nëse kjo gjë ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike dhe proporcionale për t'i arritur ato qëllime.

17. Së pari, në mbështetje të nenit 6 të Konventës një sërë ankesash u shpallën të papranueshme në periudhën e komunikimit të ankesës. Ato kishin të bënin me mangësi procedurale të lidhura me gjetje faktike dhe përfundime ligjore në lidhje me banesën në Durrës dhe zyrën në Tiranë. Në vërejtjet e tij, kërkuari rideklaroj të njëjtat pretendime si një aspekt specifik i nenit 8. Gjykata nuk ka konstatuar

dobësi serioze në procesin e vendimmarrjes me anë të të cilit u arritën gjetjet faktike të sipërpërmendura në nivel kombëtar, dhe nuk shikon arsye për të miratuar një përfundim tjetër për pranueshmërinë e atyre pretendimeve sipas nenit 8 në këtë fazë të procesit (krahaso *Thanza*, cituar më sipër, §§ 100 dhe 158).

18. Së dyti, në parashtimet e tij në vitin 2020, kërkuesi aludoi në terma të përgjithshëm për “shpërpjesëtimin flagrant” për shkarkimin e tij, por nuk ngriti argumente specifike në lidhje me justifikimin e KPA-së për shkarkimin e tij nga detyra sipas nenit 61 (3) të LV (shih *Xboxhaj*, cituar më sipër, §§ 412-13, dhe *Nikëhasani kundër Shqipërisë*, nr. 58997/18, §§ 126 dhe 128-129, 13 dhjetor 2022, për argumentet e tjerë, më të përgjithshëm). Ankesat duhet të përmbajnë të gjithë parametrat e nevojshëm në mënyrë që Gjykata të përcaktojë problematikat që do të shqyrtohen dhe nuk duhet të lënë vend për hamendësime në lidhje me qëllimin e elementeve faktike apo argumenteve juridike.

19. Në vijim, kërkuesi pretendoi se gjetjet faktike të KPA-së, interpretimi i legjislacionit vendas dhe përfundimet e tyre – duke përfshirë ato në lidhje me banesën në Durrës dhe zyrën në Tiranë – ishin të pamjaftueshme. Pasi shqyrtoi parashtimet e palëve, Gjykata nuk konstatoi arsye për t’i konsideruar gjetjet dhe përfundimet arbitrare apo qartazi të paarsyeshme. Specifikisht, kërkuesi nuk kishte provuar bindshëm: (i) ekzistencën e fondeve të mjaftueshme të ligjshme për këstin e paguar në vitin 2006 për pronën në Durrës, duke rezultuar në një gjendje financiare negative për atë vit, dhe më e rëndësishmja; (ii) duke pasur në konsideratë kombinimin e faktorëve sipas përcaktimit të KPA-së (shih paragrafin 6 më sipër), realiteti dhe përshtatshmëria e shitjes së supozuar të asaj prone në vitin 2010, dhe origjinën ligjore të 82,000 eurove të investuara në bono thesari menjëherë pas asaj periudhe. Nuk janë konstatuar mangësi në procesin e rregullt në lidhje me këto gjetje (shih paragrafin 17 më sipër). Kërkuesi ka bërë deklaratime jokonsistente në lidhje me 24,000 dollarë amerikanë të paguar në shkurt 2003. Këto arsye ishin relevante dhe të mjaftueshme për të justifikuar shkarkimin e tij nga detyra, duke pasur në konsideratë shumat e mëdha të përfshira, natyrën e parregullsive të konstatuara nga organet e vettingut, dhe pozicionin e kërkuesit si gjyqtar me eksperiencë të gjatë për të përmbushur standardet e larta të ndershmërisë në lidhje me çështjet e tij private financiare (shih *Xboxhaj* cituar më sipër, § 407 *in fine*). Nëse gjykatat vendase do të kishin shqyrtuar me kujdes faktet, do të kishin zbatuar standardet përkatëse të të drejtave të njeriut në përputhje me Konventën dhe praktikën e saj ligjore, dhe nëse do të kishin balancuar në mënyrën e duhur interesat individuale përkundrejt interesit publik në një çështje, Gjykata do të kërkonte arsye të forta për të zëvendësuar këndvështrimin e saj në lidhje me vlerësimin e gjykatave (shih *Halet kundër Luksenburgut* [DHM], nr. 21884/18, §161, 14 shkurt 2023). Për këtë arsye shkarkimi i kërkuesit nga detyra ishte proporcional me qëllimet legjitime në rrethanat e çështjes.

20. Për sa më sipër, nuk është e nevojshme që Gjykata të shqyrtojë nëse shkarkimi i kërkuesit justifikohet edhe në baza të gjetjeve dhe përfundimeve të KPA-së në lidhje me konfliktet e supozuara të interesit dhe sjelljen juridike që cenonte besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, sipas nenit 61(5) të LV (krahaso *Xboxhaj*, §§ 410-11, dhe *Thanza*, § 160, të dy cituar më sipër).

21. Në përputhje me rrethanat, ankesa bërë në mbështetje të nenit 8 është qartazi e pambështetshme në fakte dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3(a) dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime,

E shpall kërkesën të papranueshme.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 12 qershor 2025.

Olga Chernishova
Zëvendëssekretare

Úna Ní Raifeartaigh
Kryetar